

Analiza e nivelit të adoptimit të rekomandimeve nga opinionet e vlerësimit të korrupsionit mbi projektligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Procesi i miratimit dhe vlerësimit të Projektligjit “Për Policinë e Shtetit”

Projektligji për Policinë e Shtetit u depozitua zyrtarisht në Kuvend nga Këshilli i Ministrave më datë 24 qershor 2024. Ky projektligj u publikua gjithashtu në Regjistrin e Konsultimit Publik për komente dhe sugjerime nga qytetarët, gjatë periudhës 13 mars – 2 prill 2024.

Procesi i konsultimit përfshiu edhe hartimin e Corruption-Proofing of Legislation (CPL) nga ekspertët dhe stafi teknik i Kuvendit, me mbështetjen e projektit të **Westminster Foundation for Democracy** “Forcimi i Llogaridhënies së Qeverisë përmes një Parlamenti më Reagues”, i financuar nga **FCDO** përmes **Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë**, dhe bazohet në **Metodologjinë Shqiptare për Parandalimin e Korrupsionit**.

Pas këtij procesi, projektligji u miratua nga seanca plenare e Kuvendit më 26 korrik 2024 dhe u botua në Fletoren Zyrtare Nr. 141, datë 08/08/2024, si Ligji Nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”.

Projektligji iu nënshtrua një procesi vlerësimi për hapësira të mundshme për korrupsion, në kuadër të të cilit u identifikuan rreziqet dhe faktorët e riskut në dispozitat ligjore, si dhe u hartuan rekomandime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes së disa dispozitave dhe për eliminimin ose minimizimin e këtyre rreziqeve. Gjatë këtij procesi, u përgatitën 7 rekomandime për nene të caktuara të projektligjit.

Nga analiza e tekstit të ligjit të miratuar konkludohet se kundërshtimet dhe rekomandimet e CPL janë pranuar për një pjesë të neneve, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve nuk janë pranuar dhe nuk janë reflektuar në përmbajtjen e neneve përkatëse.

Konkretisht, janë pranuar rekomandimet në lidhje me:

- **Neni 28 – Pranohet rekomandimi për nenin 28 “Kontrolli në rastet kur dyshohet për akte terroriste”**, duke shtuar një pikë të re në këtë nen, e cila nuk ishte parashikuar më parë, dhe që vendos shprehimisht detyrimin për marrjen e autorizimit nga prokurori, me shkrim ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, përpara se punonjësit e Policisë së Shtetit të kryejnë me iniciativë kontrole në banesa, ndërtesa, mjedise dhe hapësira publike për parandalimin e akteve terroriste. Ky parashikim synon kufizimin e hapësirës për shpërdorim detyrë, forcimin e garancive procedurale dhe mundësimin e ushtrimit më efektiv të së drejtës së ankimit nga personi i kontrolluar.
- **Neni 35 – Pranohet rekomandimi për pikën ç) të nenit 35 për kufizimin e informacionit që mblidhen nga policia në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj nga disa burime të caktuara, ndër këto edhe “Të dhëna të tjera që mblidhen për ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në ligje të veçanta”**. Heqja e fjalës të tjera “të tjera” në këtë

burim informacioni nga formulimi fillestar ka eliminuar një koncept të papërcaktuar dhe gjithëpërfshirës, i cili krijonte hapësirë për interpretim të zgjeruar dhe diskrecional, duke siguruar mbledhjen dhe përdorimin ligjor dhe transparent të informacionit.

- **Neni 56 – Pranohet rekomandimi për përfshirjen në nenin 56** “*Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*” të një pike të re (pika 5), e cila parashikon rastet e pezullimit nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm, me urdhër të ministrit përgjegjës, konkretisht kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit.

Ky parashikim, i reflektuar në pikën 5 të nenit 56 të ligjit, synon forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe garantimin e integritetit institucional në nivelin më të lartë drejtues.

Nuk janë konsideruar rekomandimet për nenet si vijon:

- **Neni 24 – Nuk pranohet rekomandimi për pikën 1 të nenit 24**, për përcaktimin e qartë të një pozicioni apo të strukturës përgjegjëse për trajtimin e ankesave ndaj veprimeve policore dhe sigurimin e koherencës me Ligjin Nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” përmes riformulimit të dispozitës dhe shtimit të një paragrafi referues. Teksti i pikës së projektligjit dhe ligji i miratuar në këtë nen përcaktojnë kompetencës e punonjësit të policisë për trajtimin e ankesave dhe referimin në rregulloren e Policisë së Shtetit për ndjekjen e procedurave për trajtimin e tyre.

Ndërkohë, pika 4 e nenit përcakton se rregullat e hollësishme dhe mënyra e dokumentimit të trajtimit të ankesave përcaktohen në Rregulloren e Policisë së Shtetit. Sipas pikës 1 të rregullores të miratuar në vitin 2025 parashikohet se: “*Strukturat policore të çdo niveli kanë përgjegjësinë të regjistrojnë, verifikojnë, ndjekin, trajtojnë dhe të kthejnë përgjigje për çdo ankesë që bëhet ndaj veprimeve policore*”, ndërsa në vijim neni përcakton procedurat që ndiqen për trajtimin e ankesave.

- **Neni 56, pika 1 – Nuk pranohet rekomandimi për pikën 1 të nenit 56** për mënyrën e zgjedhjes dhe të emërimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Kjo pikë e nenit të projektligjit parashikon se: “*Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit*”. Kjo dispozitë nuk ka pësuar asnjë ndryshim nga drafti i projektligjit në ligjin e miratuar, pavarësisht kundërshtimeve dhe rekomandimeve të paraqitura. Kundërshtimet kanë theksuar se kjo formulë emërimi krijon një varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm nga ekzekutivi, duke cenuar

parimin e depolitizimit të Policisë së Shtetit dhe duke rritur rrezikun për ndikim politik ose ushtrim diskrecional të kompetencave. Është rekomanduar që në ligj të përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes mbi bazën e meritës dhe transparencës. Këto rekomandime nuk janë reflektuar në tekstin përfundimtar, i cili ka mbetur i pandryshuar.

Ndërkohë neni 141 i ligjit, pika 2, parashikon që ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike të nxjerrë aktet nënligjore, përfshirë ato në zbatim të nenit 56, pika 2 për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të Përgjithshëm të Policisë së shtetit. Pika 7 e të njëjtit nen parashikon që këto akte nënligjore të miratohen brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit. Brenda këtij afati, më datë 02.09.2024, Ministri i Brendshëm ka miratuar **Udhëzimin nr. 160/2024¹, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”**. Ky udhëzim përcakton procedurat që sigurojnë një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e kandidatëve për këtë pozicion.

- **Neni 60, pika 5 – Nuk pranohet rekomandimi për pikën 5 të nenit 60** për të parashikuar emërimin e drejtuesit të departamentit nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së shtetit, në vend të parashikimit të dispozitës së projektligjit që ngarkon Ministrin me këtë përgjegjësi. Kjo pikë është kundërshtuar në raportin e CPL pasi emërimi nga Ministri çënon pavarësinë operacionale të Policisë së Shtetit, duke qenë në kundërshtim me nenin 54, pika 3 të draftligjit, si dhe vlerësimet e GRECO evidentojnë se emërimet nga ekzekutivi në pozicionet e nivelit të mesëm drejtues paraqesin rrezik për politizim dhe ndikim mbi veprimtarinë operative të Policisë. Emërimi i drejtuesve të departamenteve nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ofron më shumë garanci për shmangien ose reduktimin e rrezikut të favorizimit ose subjektivizmin dhe ndikimin politik nga ministri në emërimin e drejtorëve të departamenteve.
- **Neni 83 – Nuk pranohet rekomandimi për nenin 83**, në lidhje me përcaktimin e qartë dhe specifik në ligj të organit të përbërjes, mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve, mandatit, mbikqyrjes së procesit të emërimeve të tij. Gjithashtu është kundërshtuar parashikimi për përhershmërinë e këtij organi pa kufizime të mandateve ose rotacion të anëtarëve. Këshilli mund të krijojë hapësira për praktika favorizimi ose korrupsioni, për shkak të mungesës së një mekanizmi mbikëqyrës të pavarur mbi procesin e emërimeve.

Ndërkohë në vijim, rregullorja e miratuar me VKM nr. 112, datë 24.02.2025², në nenet 80–84, përcakton funksionimin e Këshillit të Emërimeve.

¹ <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2024/09/02/160/343b787d-4e41-4149-8448-0bcbe056afe1>

² <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2025/02/24/112/3cbfb4fd-89b9-498e-8fe1-c2c0baf5d733>

- **Neni 92 – Nuk pranohet rekomandimi për riformulimin e nenit 92**, për referimin e rregullave dhe mekanizmave për sinjalizimin dhe mbrotjen e sinjalizuesve dhe të parashikimeve të ligjit për Agjencisë e Mbikqyrjes Policore, në rastet kur punonjësit e Policisë së Shtetit raportojnë paligjshmërinë apo shkeljen gjatë kryerjes së detyrës nga një punonjës tjetër policie,
- **Neni 126 – Nuk pranohet rekomandimi për riformulimin e nenit 126**, për heqjen e kompetencës së drejtuesit të departamenteve ose drejtorive vendore të japin certifikata vlerësimi për punonjësit e tyre, ose për propozimin që miratimi i dhënies së certifikatave të bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në propozimet e strukturave vendore Gjithashtu nuk është pranuar rekomandimi për përcaktimin e përkufizimeve të qarta dhe specifike në ligj për kriteret dhe dhënien e certifikatave dhe medaljeve.
Ndërkohë në zbatim të këtij neni është miratuar VKM nr. 295/2025, *“Për përcaktimin e rregullave, të kriterëve, të motivit dhe të procedurave për dhënien e medaljeve e certifikatave në Policinë e Shtetit dhe shpërblimin përkatës”*³.

Konkuzione

Implementimi dhe miratimi i 3 rekomandimeve të mësipërme kontribuon në eliminimin e rreziqeve dhe faktorëve të rrishtit në ligj. Reflektimi i rekomandimeve garanton një përforsim të ndjeshëm të garancive procedurale dhe të mekanizmave të kontrollit institucional, duke kufizuar hapësirat për diskrecion të pakontrolluar dhe shpërdorim të detyrës. Konkretisht, parashikimi i detyrimit për autorizim nga prokurori, me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik, për kryerjen e kontroleve sipas nenit 28, siguron parandalimin e praktikave në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe rrit gjurmueshmërinë dhe mundësinë e ankimit efektiv. Po ashtu, eliminimi i termit të papërcaktuar “të tjera” në pikën ç) të nenit 35 përmirëson qartësinë normative dhe kufizon interpretimin e zgjeruar, duke garantuar mbledhjen dhe përdorimin e informacionit mbi baza të përcaktuara ligjërisht. Ndërkohë, përfshirja në nenin 56 e parashikimit për pezullimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm forcon llogaridhënien në nivelin më të lartë drejtues dhe kontribuon në rritjen e integritetit institucional. Në tërësi, këto ndryshime ndikojnë pozitivisht në praktikë duke rritur sigurinë juridike, transparencën dhe besimin publik në funksionimin e Policisë së Shtetit.

³ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2025/05/28/295/078fbd6c-2cbb-4ce2-915b-81bfd407ff65>